SHENIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomike më të favorshme.

21. Konvertimi në valutë të vetme

Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.

22.Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht te ulët

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- | | |
|--|--|
| 23. Njoftimi i Fituesit | 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese. |
| 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës | <p>1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.</p> <p>2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.</p> <p>Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor; b) garanci bankare; c) garanci nga shoqëri sigurimi. |

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e çmimeve të artikujve

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përcaktimi i këtyre specifikimeve teknike është bërë duke u bazuar tek Vkm nr.83 e vitit 10/2/2021 tek standartet Europiane ne fuqi si dhe tek

Rakorderite Plastike

Rakorderite sherbejne per bashkimin dhe pershtatjen e tubave ose rakorderive plastike me permasa te ndryshme. Trupi i rakorderive te jete material Polipropilen me rezistence mekanike te larte. Produktet duhet te jene te bombarduara me rreze ultraviolet ne menyre qe mos te krijojne alga ose baktere. Gjithashtu keto rakorderi nuk duhet ne asnje menyre te krijojne mikroorganizma ne uje te pijshem. Siperfaqja e brendshme e produkteve duhet te jete homogjene dhe nuk duhet te jete poroze. Produktet nuk duhet te permbajne asnje tip substance qe ndryshojne shijen ose eren e ujit. Presioni I punes te jete 16 bar (ose me I larte) bazuar ne standartin ISO 1167-1 dhe ISO 1167-4 (ose ekuivalentet e tyre). Metoda e testimit per te kontrolluar nese ka rrjedhje pas shtrengimit te rakorderive ne tubin plastik duhet te jete sipas ISO 3458 ose ekuivalent. Rezistenca mekanike e shtrengimit te rakorderive kundrejt terheqjes se tubit duhet te jete testuar sipas standartit ISO 3501 ose ekuivalent me te. Rakorderite duhet te jene konform ISO 17885 dhe ISO 3503 (ose ekuivalente te tyre). Filetimi I tyre te jete sipas standartit ISO 7-1 ose ekuivalent. Ndryshimi ne dimensionet e produkteve te jete maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kerkuara nga AK.

RAKORDERITE ZINGATO

Rakorderite sherbejne per lidhjen dhe/ose degezimin e nje tuboje ose rakorderie me ato tubo ose rakorderi te tjera me permasa te njejta ose te ndryshme. Rakorderite duhet te jene material xingato i tipit EN-GJMĚ-400-5 (ose ekuivalent) dhe te kene te shkruar ne trup emrin e kompanise prodhuese ose marken. Ato duhet t'i rezistojne nje force minimalisht 35000 N/cm^2 pa u deformuar, dhe te kene rezistencen gradeformimi te pakten 210 HB. Te jene te mbuluar me zink ne sasi minimalisht 450 gr/m^2 dhe shtresa e zinkut mos te jete me e vogel se $65 \mu\text{m}$. Filetimi duhet te jene sipas standartit ISO 228 ose ekuivalent. Presioni qe duhet te durojne te jete minimumi 25 bar ne temperaturen nga -20°C deri ne 100°C . Te gjithë produktet duhet te jene te certifikuar per perdorim ne uje te pijshem dhe te kene certifikate sanitare. Ato duhet te jene sipas standartit EN10242 (ose ekuivalent).

TUBOT HDPE

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Te jene sipas standartit EN 12201 ose ekuivalent me te. Tubat të kenë një koeficient sigurimi minimalisht 1.20. Materialet e përdorura për prodhimin e tubave të jene jo toksike dhe të mos ndikojnë në cilësinë e ujit (mos t'i japin atij as erë as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve dhe goditjeve sizmike, për tu përshtatur me relievin e tokës. Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolet dhe ndaj temperaturave -25 derinë 55°C. Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes dhe jetegjatesi te pakten 50 vjet. Pamja e jashtme: të kenë sipërfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit. Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar ose kombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGÖ). Permasat dhe presionet e punës së tubove perkatesisht sipas preventivit.

Tuba te brinjezuar

Tubat e brinjezuar duhet te jene te strukturuar prej polietileni me densitet te larte dhe duhet te jene sipas standartit EN 13476 Tipi B ose ekuivalent me. Duhet te jene te forte ne menyre qe te mos pesojne carje apo fryrje, pra te jene konform me standartin ISO 12091, ose ekuivalent. Fortesia e unazes se ketyre tubave duhet gjithashtu te vertetohet pasi tubat te jene testuar sipas standartit EN ISO 9969, ose ekuivalent. Tubat e brinjezuar duhet te jene te prodhuar ne ate menyre qe bashkimi i tyre te behet sipas metodes nje manikote dhe 2 guarnicione dhe keto te fundit duhet te jene te prodhuara sipas standartit EN 681 ose ekuivalent me te. Tubat e brinjezuar duhet te shoqerohen me certifikaten perkatese te standartit EN13476 Tipi B (ose ekuivalent me te).

Fasheta PP

Fashetat sherbejne per krijimin e daljeve te sigurta ose linjave te reja ne tubat PE-HD sipas kerkesave. Keto fasheta duhet te jene me rezistence mekanike te larte dhe trupi i tyre te jete material Polipropilen. Fashetat PP pervec se duhet te suportojne presionin **16 bar**, gjithashtu duhet te jenë te testuara sipas standarteve ISO 17885(ose ekuivalente me te). Ndryshimi ne dimensionet e produktevete të jetë **maksimumi ± 0.5 mm** nga dimensionet e kerkuara nga AK. Qe te moskrijojne alga ose baktere, produktet duhet te jene te bombarduara me rreze ultraviolet. Rakorderite duhet te kene nje sipërfaqe te brendshme homogjene dhe nuk duhet te jete poroze. Shija dhe era e ujit duhet te mos ndryshoje ne menyre absolute, pra keto rakorderi nuk duhet te permbajne asnje tip substance qe mund te ndikojne ne to.

Keto fasheta me kompresion duhet te jene me unaze perforcuese po ashtu te galvanizuar. Filetimi i tyre te jete sipas standartit ISO 7-1 (ose ekuivalent).

Adaptor gomine-gomine

Adaptoret gomine-gomine ose ndryshe bashkueset universale sherbejne per te bashkuar ose lidhur tubo PE, PVC, gize , cemento, celiku, me fibra xhami etj.. ndermjet tyre. Bashkueset duhet ofrojne garanci dhe siguri te bashkimit te tubove me ane te elementeve te ndryshem shtese qe kane ne sektorin e mberthimit dhe shtrengimit te tubove. Bashkueset duhet te ofrojne nje tolerance midis dy aneve te bashkimit te tubove prej 8 gradesh ose me te larte, pa krijuar asnje problem. Gominat izoluese te bashkueses duhet te jete EPDM per perdorim per uji te pijshem sipas standartit EN 681-1 (ose ekuivalent). Bashkueset duhet te jene te testuara sipas standartit EN 14525 dhe EN 545 (ose ekuivalente) dhe te kene presion pune 16 bar ose me te larte. Permasat e bashkueseve universale perkatesisht sipas preventivit. Te dy krahet e bashkueses duhet te jene me gomine.

Adaptor fllanxhe-fllanxhe

Adaptoret fllanxhe-fllaxhe ose koplingjet me fllanxhe ose dhe sic njihen ndryshe fllanxh adaptor universal (taolip etj.) perdoren per te lidhur tubin me rakorderi me fllanxhe. Lidhjet fundore te fllanxhave te ketyre koplingjeve duhet te jene sipas standartit EN 1092-2 dhe temperatura e punes se ketyre fllanxh adaptoreve duhet te jete 0°C deri ne +60°C (pranohet edhe diapazon me l gjere qe perfshijne diapazonin e kerkuar). Ata duhet te jene te veshur me puder epokside me nje tashesi minimalisht 250 µm. Presioni l punes se tyre duhet te jete PN16 ose me l larte. Devijimi kendor l tyre mos te jete me shume se 5°. Bulonat e ketyre koplingjeve me fllanxhe duhet te jene prej materiali celik karboni 8.8 dhe te jene te galvanizuar ne te nxehte. Gjithashtu fundet e tyre duhet domosdoshmerisht te jene te mbrojtur me kapak plastik.

Saracineska bronxi F

Saracineskat prej bronxi duhet te jene me leve, te punojne ne presion minimumi 30 bar dhe ne temperature -15°C deri +110°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Të dy fundet e saraqineskes duhet te kene filetim femër dhe te jene konform standartit EN ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjeter te saraqineskes duhet te jene prej bronxi. Ne saraqineske duhet te jete e shenuar te dhenat baze si madhesia e saraqineskes, emri l kompanise prodhuese ose ndonje shenje e markes etj. Te jene te certifikuara per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Saraçineskave te kerkuara ne preventive jane:

Saracineska 2" ta kete gjatesine minimumi 100mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 35mm, pra minimumi 17.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 140mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 110mm.

Saracineska 1 1/ 2" ta kete gjatesine minimumi 85mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 33mm, pra 16.5 mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 140mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 100mm.

Saracineska 1 1/ 4" ta kete gjatesine minimumi 75mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 31mm, pra 15.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 110mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 82mm.

Saracineska 1" ta kete gjatesine minimumi 65mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 29mm, pra minimumi 14.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 98mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 70mm.

Saracineska 3/ 4" ta kete gjatesine minimumi 55mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 25mm, pra minimumi 12.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 98mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 64mm.

Saracineska 1/2" ta kete gjatesine minimumi 45mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 22mm, pra minimumi 11mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 80mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 51mm.

SARAQINESKA PN16

Saraqineskat duhet te jene modeli G me filetim te boshtit qe sherben per kycjen dhe ckycjen e saraqineskes, ne pjesen e brendshme te saraqineskes . Testimi dhe dizenjimi I tyre ne perputhje me standartet EN1074 dhe EN1171 (ose ekuivalente). Dimensionet e saraqineskave duhet te jene sipas standarteve EN 558-1 dhe DIN3202 (ose ekuivalente). Lidhjet fundore te fllanxhave duhet te jene sipas standarteve EN1092-2 (ose ekuivalent). Temperatura e punes se saraqineskave te jete nga -10°C - +70°C (pranohet edhe diapazon me I gjere qe perfshijne diapazonin e kerkuar).

Gjuheza, e cila ben te mundur bllokimin ose jo te rrjedhjes se ujit, duhet te jete e material gize GJS-500-7 (ose ekuivalent) e kapseluar ne gome EPDM qe lejohet per perdorim per uji te pijshem.

Trupi I saraqineskes duhet te jete material gize GJS-500-7 (ose ekuivalent). Boshti I saraqineskes te jete material I pandryshkshem inoks 1.4034 (ose ekuivalent) qe mos te kete ndikim ne ujin e pijshem per shkak te grryerjes nga uji. Saraqineskat duhet te jene te lyera ose te veshura me boje epokside minimum 250µm. Dado dhe Bulonat te jene material inoks AISI304 (ose ekuivalent), ne menyre qe mos te ndikohen nga erozioni dhe te ndikojne ne mirefunksionimin e saraqinekses. Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh ËRAS etj).

SARAQINESKA PN25

Dimensionet e saraqineskave duhet të jene sipas standarteve EN 558-1 (ose ekuivalente). Lidhjet fundore të flanaxhave duhet të jene sipas standarteve EN1092-2 (ose ekuivalent). Testimi dhe dizenjimi i tyre në perputhje me standartet EN 1171 (ose ekuivalente). Boshti i saracineskes të jete AISI 420 me fileto sipas standartit EN 10088-1 ose ekuivalent. Temperaturat e punës së saraqineskave të jete nga 0°C deri në +60°C (pranohet edhe diapazon me l gjere që përfshijne diapazonin e kerkuar). Trupi, mbulesa dhe porta e saracineskes të jene material gize (EN-GJS-500-7) sipas standartit EN 1563 ose ekuivalent me të. Dadot, bulonat dhe rondelet e saracineskes duhet të jene të zinkuara prej celiku sipas EN ISO 898-1; EN ISO 898-2 ose ekuivalente me të. Veshja brenda dhe jashtë e saracineskes duhet të behet me bojë epokside minimumi 250µm sipas DIN 30677 ose ekuivalent me të. Timoni i saracineskes duhet të jete celik i shtypur në gize dhe të behet sipas standarteve EN 10305-3 dhe EN 1563 ose ekuivalente me të..

Tuba dhe rakorderi PPR

Tubat dhe rakorderite ppr janë material polipropilen dhe kerkohen të jene të perforcuara me fibra xhami. Ato duhet të jene peshe e lehte në menyre që transportimi dhe instalimi i tyre të jete sa më i thjeshtë. Keto tuba dhe rakorderi duhet të jene konform me standartin DIN 8077 ose ekuivalent me të. Transmetimi i dritës në keto tuba dhe rakorderi nuk duhet të jete më shumë se 0.2% në menyre që të mos krijohen alga në të. Ato duhet të kene qëndrueshmeri dhe rezistence të larte ndaj gerryerjes. Tubat dhe rakorderite nuk duhet të permbajne asnjë perberes helmues apo kancerogjen, pra duhet të jene të certifikuar për përdorim në ujë të pijshëm. Izolimi i tyre duhet të jete i larte në menyre që të parandalohet humbja e nxehtësise. Tubat dhe rakorderite ppr duhet të kene një koeficient të ulet të përcueshmerise termike , jo më shumë se 0.25 W/mK.

Rakorderite HDPE EF dhe rakorderite HDPE

Rakorderite PE EF dhe rakorderite PE duhet të jenë të prodhuara me plastik HDPE 100 të pastër dhe jo plastik të ricikuar, për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Densiteti i materialit PE në keto manikota EF dhe në keto rakorderi PE të jete minimumi 0.95g/cm³. Elektromanikotat dhe rakorderite PE duhet të jene në perputhje me standartin ISO 4427 ose ekuivalent me të. Moduli i terheqjes së materialit HDPE të jete testuar dhe me pas gjetur të jene në perputhje me standartin ISO 527-2 ose ekuivalent me të. Po ashtu sforcimi i terheqjes deri në keputje të materialit hdpe të ketyre manikotave EF dhe rakorderive PE, të jete testuar dhe gjetur të jete në perputhje me standartin ISO 527-2 ose ekuivalent me të. Ky material duhet të jete i afte të duroje deri në 25 Mpa para se të keputet. Permbajtja e të zezes në karbonin e ketyre elektromanikotave dhe rakorderive PE mos të jete më pak se 2% dhe ky faktor të jete testuar dhe gjetur të jete në perputhje me standartin ASTM D 1603. Koha e induksionit të oksidimit të manikotave EF dhe rakorderive PE në 210°C mos të jete

me pak se 20 minuta dhe kjo te jete testuar dhe gjetur te jete ne perputhje me standartin EN 728 ose ekuivalent me te. Keto elektromanikota dhe rakorderi PE duhet te jene te forta dhe rezistente ndaj plasaritjeve por nese plasaritja ndodh atehere ato duhet gjithashtu te jene rezistente ne menyre qe keto plasaritje mos te hapen me tej dhe kjo te jete ne perputhje me standartin ISO 13477 dhe ISO 13479 ose ekuivalente me to. Duhet te jene te certifikuar per perdorim ne uje te pijshem dhe te shoqerohen me certifikatat perkatese. Per te treguar perputhshmerine me standartet e permendura me siper, pranohen dhe permendja e ketyre standarteve ne kataloget qe do te ofrohen per elektromanikotat dhe rakorderite PE te kerkuara.

Rakorderite Elektrofuzive HDPE100, PN 25

Rakorderite EF duhet të jenë të prodhuara me plastik HDPE 100 te paster dhe jo plastik riclikuar, për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Tensioni I punes të jetë minimumi 47V. Rakorderite duhet të jenë të pajisura me një tregues për ngjitjen, këto tregues duhet të jenë të vendosura afër me konektorët dhe të jenë te sigurta qe te mos kete rrjedhje te materialit ngjites. Te gjitha permasat e rakorderive te jenë të përshtatshme për tu salduar nga një makineri saldimi dhe kontrolli i ketyre permasave te jete testuar sipas standartit EN ISO 3126 ose ekuivalent. Lënda e parë që do te përdoret për prodhimin e rakorderive EF duhet të jetë e një cilësie tepër të lartë dhe matja e rrjedhjes se shkrijes se kesaj plastike duhet te jete konform me standartin EN ISO 1133-1 ose ekuivalent me te. Produktet duhet te jene te markuara ne trup me marken CE ose ekuivalent dhe shenjimi i tyre te jete sipas standartit EN 1555-3 ose ekuivalent me te. Rakorderite EF duhet te jete konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e tij, edhe sipas standartit ISO 4427-1 ose ekuivalentit te tij. Toleranca ne diameter dhe trashesi per secilin produkt te mos jete me shume se $\pm 5\%$. Forca hidrostatike e ketyre rakorderive te jete testuar sipas standartit EN ISO 1167-1 ose ekuivalentit e ketij te fundit. Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh ERAS etj).

Permasat dhe modelet e produkteve duhet te jene sipas preventivit

Fllanxha Celiku

Fllanxhat duhet te jene celiku te sheshta dhe sipas standartit 1092-1 (ose ekuivalent). Te gjitha fllanxhat duhet te kene presion pune 16bar.

Kundralvul (Me fllanxhe)

Kundralvulat e gizes perdoren per te parandaluar kthimin mbrapsht te rrjedhes se ujit. Kundralvulat duhet te punojne ne temperatura 0°C deri ne +60°C (pranohet edhe diapazon me l gjere qe perfshijne diapazonin e kerkuar). Kapaku I ketyre kundralvulave duhet te jete lehtesisht

I cmontueshem ne menyre qe te mund te nderrohet sfera sa here te kerkohet. Sfera e kundralvalvulave duhet te jete material alumini i vullkanizuar ne EPDM. Dizajni i kundralvalvulave te gizes kerkohet te jete konform standartit EN 12050 ose ekuivalent me te dhe lidhjet fundore te filanxhave te kundralvalvulave duhet te jene sipas standartit EN 1092-2 ose ekuivalent me te. Veshja e kundralvalvulave duhet te jete veshje puder epokside me nje trashesi minimumi 250 µm. Permasat e kundralvalvulave duhet te jene sipas standartit EN 558 dhe DIN 3202 ose ekuivalent me to.

Kundralvalvul

Kundralvalvula te jete material 100% Bronx dhe duhet te jene me pallot. Mekanizmi I bllokimit te rrjedhjes se ujit ne te kundert duhet te jete I veshur me gomine. Presioni i punes te jete minimumi 20 bar dhe temperatura e punes -10°C deri +110°C. Të dy fundet e kundralvalvules duhet te kene filetim femër dhe te jene konform standartit EN ISO 228 (ose ekuivalent). Kundralvalvula duhet te kete te shenuar te dhenat baze ne trup si madhesia e saj, drejtimin e rrjedhjes etj. Kundralvalvulat duhe te jene te certifikuara per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Kundralvalvulave perkatesisht sipas radhes ne preventiv jane:

Kundralvalvula 3/4" ta kete gjatesine minimumi 50mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 23mm, pra minimumi 11.5 mm nga secili krah. Lartesia totale te jete minimumi 55mm.

Kundralvalvula 1/2" ta kete gjatesine minimumi 45mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 23mm, pra minimumi 11.5 mm nga secili krah. Lartesia totale te jete minimumi 45mm

KUNDRAVALVUL THITHESE

Kundralvalvula te jete material 100% bronx .Mekanizmi I bllokimit te rrjedhjes se ujit ne te kundert duhet te jete bronxi. Presioni i punes te jete minimumi 16 bar dhe temperatura e punes -15°C deri +110°C. njeri nga fundet e kundralvalvules duhet te kete filetim femër dhe te jete konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent) ndersa ne krahun tjetër te jete e pajisur me nje site(filter) Kundralvalvula duhet te kete te shenuar te dhenat baze ne trup si madhesia e saj, drejtimin e rrjedhjes etj. Kundralvalvulat duhe te jene te certifikuara per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Kundralvalvulave perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Kundralvalvul thithese 2" ta kete lartesine minimumi 85mm dhe gjeresia totale e produktit te jete minimum 75mm.

Kundralvalvul thithese 1 e 1/4" ta kete lartesine minimumi 74mm dhe gjeresia totale e produktit te jete minimumi 54mm.

Mates uji DN250;DN200;DN150;DN100;DN80;DN65;DN50

Matesi i ujit I thate I tipit Ëoltman, per uje te ftohte duhet te jete sipas standarteve te Bashkimit European 2014/32/EU ose kerkesave te MID (ose ekuivalent).

Matesi duhet te jete i certifikuar per perdorim per ujin te pijshem dhe kjo te vertetohet me certifikatat perkatese. Pesha e matesit duhet te jete max (, 11 kg per matesin DN65; max 14.5 kg per matesin DN80 dhe max 16 kg per matesin DN100) pesha me te vogla jane te pranueshme. Matesi duhet te jete konform standarit EN-14154:2005-1, 2 dhe 3 (ose ekuivalente) si dhe duhet te kete ndjeshmeri te larte ne rrjedhjen e ujin duke matur edhe sasi shume te vogla te ujit qe kalojne ne mates. Ai duhet te filloj te mase rrjedhjet 0.15 m³/h (rrjedhje me sasi me te vogla jane te pranueshme.) Gjatesia e matesit duhet te jete max , 200mm per matesin DN 65; max 225mm per matesin DN80 dhe max 250mm per matesin DN100; vlera me te vogla jane te pranueshme. Lartesia te jete max, 200mm per matesin DN 65mm, max 220 per matesin DN80mm dhe max 230mm per matesin DN100mm; vlera me te vogla jane te pranueshme.

Fusha e matesit qe tregon matjen e ujit te konsumuar duhet te jene te mbyllur ne menyre hermetike, ne nje kase qe nuk krijon kondensim per te penguar leximin dhe te kete minimumi 6 rulona me numra dhe tre shigjeta treguese si dhe fusha e matesit te ofroje mundesine per tu rrotulluar 360°. Fusha duhet te jete e mbrojtur me ane te nje kapaku dhe te jete e mbyllur direkt ne trupin e matesit per te shmangur cdo lloj nderhyrje te mundshme.

Matesi i ujit duhet te ofroje mundesine dhe te jete kompatibel me teknologjine e Leximit Automatik te Matesit, te suportojte vendosjen e nje moduli transmetimi te te dhenave. Ai duhet te punoje si ne pozicion horizontal dhe shkalla e saktetise se matjes te jete R100 (pranohen edhe vlera me te larta), edhe ne pozicion vertikal ku shkalla e skatesise se matjes te jete R40 (pranohen edhe vlera me te larta).

Mates uji DN						
Diametriimate sit DN		mm	50	65	80	150
Rrjedha e perhershme Q3		m ³ /h	40	63	100	400
Rrjedha maksimale Q4		m ³ /h	50	78.75	125	500
Rrjedha indirekte Q2	Montim horizontal	m ³ /h	0.64	0.806	1	3.2
Rrjedha minimale Q1	Montim horizontal	m ³ /h	0.4	0.504	0.625	2
Rrjedha fillestare		m ³ /h	0.15	0.2	0.25	1.0
Raporti Q2/Q1			1.6	1.6	1.6	1.6

Temperatura nominale e punes			T30	T30	T30	T30
Klasa e ndjeshmerise se tipeve te rrjedhjes			U0, D0	U0, D0	U0, D0	U0, D0
Rregjistrimi maksimal		m3	10 ⁶	10 ⁶	10 ⁶	10 ⁷
Saktesia e treguesit		l	0.0005	0.0005	0.0005	0.005
Diapazoni i presionit te punes		bar	0.3-16	0.3-16	0.3-16	0.3-16
Humbja maksimale e presionit		kPa	ΔP10	ΔP16	ΔP10	ΔP10
Gabimi maksimal i lejuar ndermjet Q2 dhe Q4		%	± 2	± 2	± 2	± 2
Lidhjet fundore			Fllanxha DN50	Fllanxha DNmm	Fllanxha DN80 mm	Fllanxha DN150 mm

Mates uji single jet DN ½" / ¾" / 1" / 1 ½"

Matesi i ujit per uje te ftohte duhet te jete sipas standarteve te Bashkimit European

2014/32/EU ose kerkesave te MID (ose ekuivalent).

Matesi duhet te jete i certifikuar per perdorim per ujin te pijshem dhe kjo te vertetohet me certifikatat perkatese.

Matesat e ujit duhet te jene me fushe te thate dhe te mbyllur hermetikisht me vakum ne menyre qe te mundesohet nje lexim i paster dhe i qarte per nje kohe te gjate. Numrat ne fushen e matesit duhet te jene te ndare me 2 ngjyra, 5 numra me ngjyre te zeze qe tregojne m3 dhe tre numra me ngjyre te kuqe qe tregojne nenfishat e m3). Matesat gjithashtu duhet te kene element sigurie (vule) per te dalluar nese eshte ushtruar force mbi fushen e tij per te penguar levizjen e lire te numratorit.

Matesat e ujit single jet duhet te jene te pershtatshem per te lexuar uje te ftohte me temperatura nga 0-30oC dhe per uje te ngrohete nga 30 deri ne 90oC. Diapazone te tjera qe i perfshijne diapazonet e kerkuara do te pranohen.

Matesat duhet te transmetojne te dhenat magnetikisht dhe duhet te mos ndikohen nga fusha te tjera te jashtme magnetike qe pengojne leximin e te dhenave. Fusha e matesave duhet te jene te rrotullueshme 360 grade.

Matesat e ujit duhet te jene ne perputhje me standartin EN ISO 4064:2017 ose ekuivalent me te. Testimet e matesave duhet te jene kryer sipas OIML R 49 ose ekuivalente me te.

Matesat duhet te suportojne nje pajisje apo modul qe te lexohen te dhenat ne distance. Ne fushen e matesit duhet te kete te shenuar vitin e prodhimit te matesit dhe prodhuesin e tij.

Diametri nominal DN	15	20	25	40
Raporti Q3/Q1	R100	R100	R100	R100
Rrjedha e perhershme Q3 (m3/h)	2.5	4	6.3	16
Rrjedha minimale Q1 (m3/h)	0.025	0.04	0.06	0.16
Rrjedha e mbingarkeses Q4 (m3/h)	3.125	5	7.8	20
Rrjedha kalimtare Q2 (m3/h)	0.04	0.06	0.1	0.25
Klasa e sakesise	2			
